

AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "A.Z.Studio" SHPK

AKT THEMELIMI

I

Shoqërisë Tregtare Me Përgjegjësi Të Kufizuar
"A.Z.Studio" sh.p.k.

Themeluesit (OSE THEMELUESI SIPAS RASTIT NESE DO JETE VETEM NJE ORTAK)
qe firmos me poshtë:

Genti PINA, i datl. 21.05.1986, lindur ne Lushnje dhe banues ne Tirane.

Që në vijim do të përbejnë Asamblenë e Përgjithshme te Shoqërisë.
Sot më date 11.07.2023 bazuar në vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me ligjin
nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", vendosën të themelojnë Shoqërinë
me Përgjegjësi të Kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

KREU 1 OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1 Objekti i Shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë veprimtari me objekt:

Studim, projektim, për ndërtim e zbatim të veprave ndërtimore të të gjitha llojeve
sipas legjislacionit shqiptar. Studime urbanistike; mbikëqyrje dhe kolaudim
punimesh zbatimi, planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash
mbajtëse beton-arme, metalike, druri; projektim rrugësh urbane, rruge interurbane
kryesore dhe sekondare, autostrada; projektim ujësjellës, kanalizime, vepra ujitje,
kullimi, etj.

Neni 2 Emërtimi dhe Selia Juridike e Shoqërisë

1. Ortaket themelues vendosin qe shoqërinë ta emërtojnë "A.Z.Studio" sh.p.k
2. Selia e Shoqërisë ndodhet në rruga "Frosina Plaku" Tirane, Shqipëri.
3. Shoqëria mund të krijojë degë, zyra përfaqësimi e filiale brenda ose jashtë
territorit të Republikës së Shqipërisë.

AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "A.Z.Studio" SHPK

Neni 3

Regjimi Juridik

1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimitaria e saj i nënshtronhet dispozitave të Akitit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
2. Shoqëria gjëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.
3. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

KREU II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqërisë

1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
2. Shoqëria gjëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqëria ka të drejte të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose në ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj themeltar dhe me të mirat e pasurisë së saj.

Neni 5

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

KREU III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

Kapitali themeltar është 100 (njëqind) Leke dhe zotërohet 100% nga ortaku i Genti PINA.

KREU IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

Vendimet në shoqëri merren nga Asambleja e Përgjithshme. Këto vendime shënohen në Librin e Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë, eksperti kontabël i autorizuar dhe drejtuesi teknik caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE "A.Z.Studio" SHPK

**KREU V
ADMINISTRIMI**

Neni 8

Administrimi i Shoqërisë do te behet ne përputhje me Statutin qe i bashkëngjitet këtij Akti.

**KREU VI
DISPOZITA TE TJERA**

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i ndahet Ortakeve te shoqërisë sipas pjesëve kontribuuese ne kapitalin themeltar.
2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne katër kopje, te gjitha me te njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron ne dokumentacionin baze te Shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES

Genti Pina

